E.Rev.nr.13/2018

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Auto Shkolla ''A.'' me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit S.A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës K. e S. ''E.''(ish G. E.), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit E. N. – B., juriste nga Prishtina, për shkak të fitimit të humbur, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ae.nr.321/2017 datë 15.1.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28.5.2018, merr këtë

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, Ae.nr.321/2017 datë 15.1.2018, në pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e cila ka të bëjë me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditësit në shumën prej 15.410,21 €.

Pjesa I dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë mbeten të pa shqyrtuara.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë Ae.nr.321/2017 datë 15.1.2018, është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e paditësit Auto shkolla "A." dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.223/16 datë 7.11.2017, vetëm në pikën **III** të dispozitivit sa i përket shpenzimeve

procedurale, dhe është detyruar e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj shumën prej 2,813.20 €, ndërsa është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për shpenzimet e procedurës mbi ketë shumë deri në shumën prej 5,801.20 €. Pjesa I e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr. 223/2016 datë 7.11.2017, është vërtetuar, e cila ka të bëjë me detyrimin e të paditurës Kompania e Sigurimeve "E." (ish G. E.), me seli në Prishtinë, që paditësit t 'ia paguaj në emër të fitimit të humbur shumën prej 172.00 € (njëqind shtatë dhjetë e dy euro), me kamat të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat prej 1 viti pa destinim të caktuar duke filluar nga data 31.5.2012, e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit me detyrim, dhe pjesa II e dispozitivit me të cilën është refuzuar si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë në vlerë prej 15.410,21 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen ose ato të ndryshohen, ashtu që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit.

E paditura ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit, me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar, ngase nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në bazë të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me zbatimin e gabuar të drejtës materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK -ës, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se në mes palëve në procedurë nuk ishte kontestues fakti se automjeti i paditësit i markës Volkswagen Tip 1 K 1.9 TDI, me targë të regjistrimit ..., në fatkeqësinë e komunikacionit më datë 31.3.2012, kishte pësuar dëm material. Me aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut, C.nr.264/2012 datë 17.9.2012, është detyruar e paditura që

paditësit në emër të dëmit material t'ia paguaj shumën prej 2.976,00 €, ndërsa është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për fitimin e humbur. Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesës me aktgjykimin Ae.nr. 25/2012 datë 16.5.2014, e ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim duke zbatuar rekomandimet e Gjykatës së Apelit ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit për fitimin e humbur është e bazuar në shumën prej 172,00 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë në shumën prej 15.410,21 €, është e pabazuar, pastaj ka vendosur më afër përshkruar në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës pjesërisht ka aprovuar ankesën e paditësit dhe aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar në pjesën e cila ka të bëjë me shpenzimet e procedurës kontestimore, ndërsa për pjesën tjetër të aktgjykimit ka pranuar konstatimet dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe ankesën e paditësit në këto pjesë e ka refuzuar si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë, ndërsa nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimin e paditësit të cekur në revizion, se aktgjykimi është marrë me shkelje thelbësore nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK- ës, siç theksohet, se arsyetimi i aktgjykimit nuk përmban arsyet mbi faktet vendimtare për marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm, sepse gjykata nuk ka vlerësuar sjelljet e të padituës për zvarritjen e riparimit të automjetit, që përbënë elementin thelbësor në përcaktimin e kohës reale të nevojshme për riparimin e automjetit, Gjykata Supreme e Kosovës e ka vlerësuar si të pabazuar, ngase gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejt dhe i bazuar në ligj kur ka

refuzuar kompensimin e fitimit të munguar për periudhën më të gjatë kohore se 11 ditë, ngase eksperti për vlerësimin e dëmit N. Sh., në ekspertizën e tij dhe plotësimin e ekspertizës ka konstatuar se koha e arsyeshme për rregullimin e automjetit është 3 deri në 4 ditë , ndërsa liferimi i pjesëve kur nuk janë në stok 7 ditë, andaj koha e arsyeshme për riparimin e automjetit është gjithsejtë 11 ditë, ndërsa eksperti i aktuaristikës A. B., ka konstatuar se paditësi për shkak të pamundësisë së zhvillimit të veprimtarisë (trajnimi i kandidatëve në auto shkollë) ka pësuar fitim të humbur në shumën prej 172,00 €.

Paditësi ka kërkuar kompensimin e fitimit të humbur për periudhën nga data 31.3.2012 e deri më 3.1.2015, në shumën prej 15.582,21 €, por nuk ka ofruar prova se cilat veprime të mundeshe i ka ndërmarrë në mënyrë që pasojat të jen më të vogla, ndërsa e paditura brenda 4 ditëve paditësit i ka bërë ofertën e parë për rregullimin e automjetit dhe më datë 30.5.2012 ofertën e dytë, kështu që në veprimet e të padituës gjykatat nuk kanë gjete lëshime të cilat kishin me ndikuar që paditësi të pësON humbje për mos ushtrimin e veprimtarisë.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se pretendimi i paditësit lidhur me zbatimin e gabuar të drejtës materiale, është i pabazuar, nga fakti se gjykatat e instancës më të ulët me të drejt kanë vlerësuar se i dëmtuari (këtu paditësi) me veprimet e tij ka kontribuar që të krijohet dëm më i madh nga sa do të ishte zakonisht, andaj refuzimi i kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit përtej shumës së aprovuar, është konform dispozitës ligjore nga neni 189 par. 3 dhe nenit 190 të LMD –ës, siç me të drejtë kanë konstatuar edhe gjykatat e instancës më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi thinjet e cekura në revizion se automjetin e dëmtuar e ka pasur mjet themelor të punës; se e paditura nuk ka pranuar ofertat e paditësit që automjetin ta riparojë në auto serviset sipas preferencës së tij dhe nuk ka pas të holla për riparim, por të njëjtat nuk ndikuan që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe nga ajo që kanë vendosur gjykatat e instancës më të ulët, sepse këto pretendime kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilat në bazë të nenit 214 par.2 të LPK –ës revizioni nuk mund të paraqitet, ndërsa shton se pretendimet e cekura kanë qenë objekt shqyrtimi edhe para gjykatave të instancës më të ulët të cilat kanë dhen arsye të bollshme, e të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk shqyrtoi pjesën I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ngase të njëjtat nuk u kundërshtuan me revizion.

Nga sa u tha më lart, e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
E.Rev.nr.13/2018, datë 28.5.2018

Kryetarja e kolegjit,
Emine Kaçiku